

## 205 TË DHËNAT PËR BOTIMIN

Fusha përmban të dhëna për botimin e njësisë, të dhëna të tjera shtesë për botimin dhe të dhëna për përgjegjësinë. Kjo fushë është në përputhje me zonën e botimit në ISBD.

### Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
205	Të dhënat për botimin	nr
<b>a</b>	<i>Botimi</i>	nr
<b>b</b>	<i>Ribotimi</i>	r
<b>d</b>	<i>Të dhëna paralele për botimin</i>	r
<b>f</b>	<i>Përgjegjësia lidhur me botimin</i>	r
<b>g</b>	<i>Persona të tjerë përgjegjës</i>	r

### Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 205a Botimi

Fjala, fraza ose grupi i karaktereve në formën e përgjegjësisë formale që identifikon njësinë si pjesë të një botimi. Nënfushë nuk është e përsëritshme, për këtë arsye të dhënat shtesë për botimin shënohen në nënfushën b.

### 205b Ribotimi

Fusha përmban të dhëna shtesë për botimin, që janë të dhënat për shtypjen ose rishtypjen (shih shembujt 5, 7, 8, 10, 13, 15, 19) ose të dhënat alternative për botimin (shih shembujt 6, 14). Nënfusha përsëritet për rishtypjen paralel (shih shembullin 15) ose shtesë.

Nënfusha është në përputhje me të dhënat shtesë për botimin në ISBD.

### 205d Të dhëna paralele për botimin

Të dhëna për botimin në gjuhën dhe/ose shkrimin tjetër që dallon nga të dhënat për botimin në nënfushën a (shih shembujt 9, 15, 20). Nënfusha përsëritet për çdo të dhënë paralele shtesë.

## 205f Përgjegjësia lidhur me botimin

Përgjegjësia e parë që lidhet me botimin. Mund të vendoset pas nënfushave a, b ose d (shih shembujt 7, 9, 14, 16, 18). Nënfusha përsëritet për çdo përgjegjësi paralele (shih shembullin 9) dhe për përgjegjësitë e para që kanë të bëjnë me botimet shtesë.

## 205g Persona të tjerë përgjegjës

Përgjegjësia tjetër që lidhet me botimin. Nodhet pas nënfushës f (shih shembullin 7). E përsëritshme për përgjegjësi të tjera paralele dhe shtesë (shih shembullin 16).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Shënimet në fushë bëhen në formën dhe renditjen që e përcakton ISBD-ja. Lidhja midis nënfushave dhe elementeve të ISBD-së duket në tabelën poshtë.

NËNFUSHA	EMRI I ELEMENTIT	PIKA ISBD(G)	SHENJA E PIKËSIMIT
<b>a</b>	Botimi	2.1	zonë e re
<b>b</b>	Dalja nga shtypi	2.4	,
<b>d</b>	Të dhëna paralele për botimin	2.2	=
<b>f</b>	Përgjegjësia lidhur me botimin	2.3, 2.5	/
<b>g</b>	Persona të tjerë përgjegjës	2.3, 2.5	;

Të dhënat për përgjegjësinë vendosen menjëherë pas të dhënave përkatëse për botimin ose rishtypjen. Nëse e dhëna për përgjegjësinë ka të bëjë me veprën në tërësi dhe jo me botimin ose rishtypjen e veçantë, ajo vendoset në nënfushën 200f ose g. Në disa raste një përgjegjësi mund të përmbaj disa emra (shih shembujt 8, 16).

Nëse në njësi nuk është dhënë botimi por vetëm të dhënat për shtypjen apo rishtypjen, kjo e fundit vendoset në nënfushën a (shih shembujt 4, 12).

### Të dhënat paralele

Sipas ISBD-së, të dhënat paralele (të dhënat e përsëritura në një gjuhë dhe/ose shkrim tjetër) që ndodhen në njësi identifikohen me shenjën e barazimit. Shenja e barazimit të nënfusha 205d vendoset në mënyrë automatike (shih shembujt 9, 15, 20).

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

- 200** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË*  
Fusha përmban të dhënat për përgjegjësinë që lidhen me veprën si tërësi.
- 305** *SHËNIMI PËR BOTIMIN DHE HISTORINË BIBLIOGRAFIKE\*\**  
Fusha përdoret për shënimet rreth botimit.
- 7XX** *BLLOKU I TË DHËNAVE PËR PËRGJEGJËSINË*

Emrat që lidhen me botimin vendosen në bllokun 7XX.

## SHEMBUJ

1.

205	□□	<b>a</b> 16th ed.
-----	----	-------------------

2.

205	□□	<b>a</b> New and revised ed.
-----	----	------------------------------

3.

205	□□	<b>a</b> Large print ed.
-----	----	--------------------------

4.

205	□□	<b>a</b> 2nd impression <i>(Në njësi nuk është e dhëna për botimin, për këtë arsye e dhëna për rishtypjen është vendosur në nënfushën a.)</i>
-----	----	--

5.

205	□□	<b>a</b> 3rd ed. <b>b</b> 2nd (corrected) impression <i>(Në njësi është shënuar "Third edition. Second (corrected) impression".)</i>
-----	----	---

6.

205	□□	<b>a</b> Englishfull ed. <b>b</b> 4th international ed. <i>(Botimi i plotë anglez i KDUS-së është përcaktuar edhe si "Fourth international edition". Të dhënat alternative për botimin vendosen në nënfushën b.)</i>
-----	----	---

7.

205	□□	<b>a</b> 2nd ed. <b>b</b> reissued <b>f</b> with a foreword by Magnus Magnusson <b>g</b> extra notes by P. Gardner <i>(Rishtypja e botimit të dytë ka dal me parathënie të Magnus Magnusson dhe shënime shtesë të P. Gardner.)</i>
-----	----	---

8.

205	□□	<b>a</b> 4th ed. <b>f</b> revised by H. G. Le Mesurier and E. McIntosh <b>b</b> reprinted with corrections <i>(Botimin e katërt e kanë përpunuar H. G. Le Mesurier dhe E. McIntosh. Rishtypja është bërë me përmirësime.)</i>
-----	----	--

9.

205	□□	<b>a</b> 2nd ed. <b>f</b> edited by Larry C. Lewis <b>d</b> 2e éd. <b>f</b> rédigé par Larry C. Lewis <i>(Njësia me të dhëna paralele për botimin dhe të dhënat e përgjegjesisë për botimin.)</i>
-----	----	--

10. \* COBISS.net

205	□□	<b>a</b> Bot. 3 <b>b</b> rishtypja 2 <i>(Regjistrimi për rishtypjen e dytë të botimit të tretë. Termi për botimin shkurtohet.)</i>
-----	----	---

11. \* COBISS.net

205	□□	<b>a</b> Versioni 3.0
-----	----	-----------------------

*(Regjistrimi për burimin elektronik. Edhe termat në lidhshmëri siç është p.sh. versioni mund të tregojnë të dhëna për botimin.)*

## 12. \* COBISS.net

205 □□ **a**Rishtypa 2  
*(Kur në njësi nuk ka të dhëna për botimin e dhëna për rishtypjen vendoset në nënfushën a.)*

## 13. \* COBISS.net

205 □□ **a**Bot. jubile me rastin e njëqindvjetorit të lindjes së artistit **bshtypja 1**  
*(Regjistrimi për shtypjen e parë të botimit jubile Vjeshta në qytetin tim. Të dhënat për botimin përshkruhen nga njësia.)*

## 14. \*

205 □□ **a**Faksimile **b**bibliofilska izd. **f**uredila Marija Hernja Masten  
*(Të dhënat alternative për botimin vendosen në nënfushën b. Në njësi është edhe e dhëna e përgjegjësive për botimin.)*

## 15. \* COBISS.net

205 □□ **a**Bot. 3 i përpunuar **brishtypja 1 d3.**, átdolgozott kiad. **b1.** nyomás  
*(Njësia me të dhëna paralele për botimin dhe shtypjen në gjuhën hungareze.)*

Shfaqja në formatin ISBD:

Bot. 3 i përpunuar, rishtypja 1 = 3., átdolgozott kiad., 1. nyomás

## 16. \* COBISS.net

205 □□ **a**Bot. i ri, i plotësuar. **f**[redaktoi Valon Heda **gpërkthimi i tekstit të ri Nik Brihman, Syzana Jashari g**fotografitë në faqet për Shqipërinë Besart Bega]  
*(Redaktori i botimit të plotësuar është shënuar në nënfushën f, ndërsa përgjegjësitë e tjera në nënfushat e përsëritura g. Të dhënat që nuk janë marrë nga faqja e titullit janë vendosur në kllapa katrore.)*

## 17. \* COBISS.net

205 □□ **a**Bot. 3 i korigjuar dhe i plotësuar  
*(Të dhënat për botimin përshkruhen nga njësia. Termi për botimin shkurtohet.)*

## 18. \* COBISS.net

205 □□ **a**Bot. në gjuhën shipe **fpërgatiti** Marilena Heta  
*(Regjistrimi për botimin në gjuhën shqipe me përgjegjësinë për botimin.)*

## 19. \*

205 □□ **a5.** izd. **b**[1. ekavsko]  
*(Regjistrim për versionin "ekavica" të botimit të 5-të. Të dhënat nuk janë marrë nga burimi i përshkruar, prandaj janë vendosur brenda kllapave katrore. Termi për botimin shkurtohet.)*

## 20. \*

001 □□ **7cb**  
205 □□ **a**[2.допуњено изд. **d2nd** supplemented ed.]  
*(E dhëna për botimin është në shkrim cirilik dhe latin.)*

Shfaqja në formatin ISBD:

[2. допуњено изд. = 2nd supplemented ed.]